



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 22

Datë: 31. 05. 2017, ora: 16:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Ercan Spat, Nenad Rikallo, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC.

Miradije Meha, drejtoreshë e DAP-it. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së,

2. Aktivitetet e Sekretariatit lidhur me procesin zgjedhor,

3. Aktivitetet e ZRPP-së,

- *Rekomandim për akreditimin e vëzhguesve grupi i dytë,*

4. Raport i Këshillave të KQZ-së,

- Këshilli për Operacione Zgjedhore,

- *Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave të KKZ-ve për ndryshim të Lokacioneve për QV lidhur Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2017 sipas Komunave,*

- *Shqyrtimi dhe miratimi i përbërjes së KVV-ve, sipas Komunave për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës, 2017,*

-Shqyrtimi dhe miratimi i dokumentin përmbledhës për certifikimin e Listës përfundimtare të Votuesve për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2017;

-Shqyrtimi dhe miratimi i anëtarit të KKZ-së në Istog

5. Të ndryshme;

1. Hyrje

Valdete Daka: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, rendin e ditës e keni para jush. A ka dikush vërejtje? Po urdhëro Betim.

Betim Gjoshi: Unë kryetare realisht nuk kam vërejtje, por kam një propozim për të diskutuar si pikë e rendit të ditës mendoj që është interes i të gjithëve më së shumti procesi zgjedhor. Ju siç e dini tashmë Komisioni Qendror i Zgjedhor në dy zgjedhjet e fundit ka mbërrirë një standart jashtë zakonisht të mirë, sa i përket organizimit të zgjedhjeve por kemi pasur kritikë të vazhdueshme sa i përket votave për kandidat, jo se kemi pasur ndonjë ankesë kështu por kemi pasur ankesa publike edhe unë propozoj sot që ta fusim në rend dite ta diskutojmë dhe ta gjejm një metodologji dhe mekanizëm se si ta mbrojmë si Komision Qendror Zgjedhor për ta mbrojtur votën e kandidatëve që të hudhet secilla votë të shkoj në vendin e duhur. Këtë e bëjmë me qëllim që është e rëndësishme po aq sa vota për subjekte politike për neve si instucion është po aq e rëndësishme edhe mbrojtur me ligj edhe votat për subjektin politik, kandidat të subjektit politik realisht këtë e mbron edhe ligji njejt e mbron edhe kodi penal në të njejtën mënyrë kështu që unë kisha propozu besoj që është interes i të gjithëve nuk jemi vonë jemi para trajnimeve të komisionerëve që ne sot diskutojmë se si të gjejmë metoda që vota e votuesit të shkoj në vendin e duhur edhe sa i përket votës preferenciale për kandidat të subjekteve politike. Unë kam disa ide besoj që edhe kolegët tjer mund të plotësojnë por nuk do të thotë që sot ne mund të marrim vendim por ndoshta sekretariati deri në mbledhjen e ardhshme mund të na vij me një propozim mbazë diskutimeve tona, faleminderit.

Valdete Daka: Faleminderit Betim, po është e vërtetë që qdo votë duhet të shkojë aty ku votuesi ka votuar.

Enis Halimi: A mundem shkurt? Përshëndetje të gjithëve, nuk është konkretizuar sa duhet, ndoshta elabërohet kur i vjen rradha, personalisht nuk ke mjaftueshëm e qartë po pa dyshim që cdo votë duhet me u siguruar që mbërrin në adresën e duhur jo vetëm vota preferenciale por edhe vota para së gjithash edhe për subjekte politike sikurse cdo votues të ketë mundësi që ta shfrytëzojë të drejtën e tij kushtetuese për të votuar në mënyrë të pa cenueshme dhe të pa

ndikueshme , është e vertetë që kjo përgjegjësi ligjore dhe kushtetuese me garantu këtë gjë unë nuk e kam të qartë qysh mund të difenencu por e diskutojmë le të shohim qfarë ide ka për këtë.

Valdete Daka: Ta fusim në rendin e ditës e pastaj gjithkush e diskuton atëherë mos ta shtjerrim debatin tash. Atëhere kush është për këtë rendë dite. Faleminderit. Vazhdojmë me pikën e parë, aktivitetet e sekretariatit, urdhëro.

Enis Hamili: Sekretariati i Komitetit Qëndrorë të Zgjedhjeve ka vijuar me aktivitetin e vet në kuptim të përmbushjes të obligimeve që dalin dhe me synimin për ta implementuar këtë process zgjedhorë, disa aktivitete të cilat janë finalizuar si të tilla janë proceduar në pikat vijuese të rendit të ditës si kundër është ta zëmë lista përfundimtare e votuesve, nominimet për këshillat e vendotimeve , aktivitetet tjera, pra të gjitha këto janë sit ë tilla të përfunduara janë proceduar për mbledhjen e këshillave përkatës dhe më pastaj edhe në pastaj edhe në Komisionin Qëndrorë Zgjedhorë. Në bransha tjera dmth në qendrat e numërimit dhe të rezultateve po vijojnë përgaditjet e fundit për të filluar trjanimi i stafit që do të shërbej atje gjatë periudhës së numërimit të votive dhe të përpunimit të rezultateve. Ajo që kisha për të theksuar sot, ne kemi mbajtur një takim të sigurisë me akterët e sigurisë të përfshirë në këtë process zgjedhorë, conform planeve tona që kemi pasur operacionale të sigurisë. Kaq sa për aktivitetin e sekretariatit të mos detajizohemi më shumë pa pasur nevojë. Faleminderit.

Valdete Daka: Faleminderit kryeshef, a ka dikush ndonjë pyetje lidhur me këto aktivitete, nëse jo vazhdojmë me pikën tjetër, ajo është raporti I këshillave të KQZ-se , Këshilli për Operacione Zgjedhore. Urdhëro.

Adnan Rrustemi: Faleminderit. Së pari me sap o e shoh pika po e quaje kushtimisht apo pika e parë e rendit të ditës që ka të bëjë me Këshillin Operacional zgjedhorë, anëtarët e këshillit e dinë që Këshilli I Operacionit Zgjedhorë e ka shqyrtuar këtë kërkesë, thjeshtë ka kërkuar nga sekretariati që ta përgaditë një analizë të veçantë që përshkruan dhe analizon secilin rastë secilën kërkesë, sa për informacion këtu bëhet fjalë për një listë të kërkesave të disa komisioneve komunale për disa komuna për ndërimin e lokacionit të qendrave të votimit. KOZ-i, siq e thashë nuk e ka shqyrtuar ka kërkuar analizë me shkrimë nga sekretariati duke e përfshirë edhe atë siq është thënë në këshillë që sekretariati ta vlersojë që mundë ta marrë përsipër si aktivitet teknikë këtë gjë, edhe informimin e votuesve sepse jemi në një fazë të vonshme për këtë aktivitet u dasht të përfundojë që me kohë para se të filloj periudha e shërbimit votues, para se të publikohet makina kërkuese, para se të informohen votuesit e kështu mme rradhë, megjithëatë në raste të jashtëzakonshme , të veqanta ne duhet të përgjigjemi nuk ka asnjë dyshim por kjo analizë përfundonë sit ë till unë nuk mundem as ta rekomandojë në emër të Këshillit Operacional Zgjedhorë ne mund ta diskutojmë si anëtarë të KQZ-së, por mungon ajo analiza.

Betim Gjoshi: Ne, dje e kemi diskutuar këtë qeshtje dhe kanë mdetur dy qështje, kompletëajo që tha Adnani qëndron edhe mbetet një garancion I kryeshefit se a mundet ti informojë këta votues në mënyrën e duhur. Unë personalisht jamë interseuar siq besoj që janë interesuar edhe

kolegët tonë për me pa edhe KKZ qfarë ka ndodhur, realishtë kjo qështje që neve sot po na kërkohet që me vendos në aspektin teknikë dhe procedural është qeshtje e kryer KKZ-të. Këto janë sjellë në KKZ dhe janë miratuar ne jemi njoftuar të fundi, ne jemi para një akti dmth që sot mi miratu këto ndryshime që tashmë I kanë bërë KKZ-të, të paktën dy komuna e kanë verifikuar personalisht edhe e dyta është që ne ta urdhërojmë sekretariatit që të gjejmë mundësi të informimit këta votues , në disa komuna kanë filluar ti informojnë këta votues për këto ndryshimë, kështu që janë në përputhje me ligjin ose me aktet brendshme kanë vepruar kësaj here, ne e dimë kur është një afat për vlerësimin e qendrave, por, ne tash për të mos krijuar dilemma te votuesit nuk na ka mbetur rrugë tjetër përveq se mi votu, ne mund ti shtyjme dhe në mbledhjen e ardhëshme pas një analize edhe më të gjerë edhe nuk jamë mu ngut sot por ky është realiteti dmth për fatë të keq edhe këtu duhet të tërhiqet një vërejtje sekretariatit që të mos ndërhyjë në kompetenca që nuk janë të tyre edhe të veproj me kohë p.sh thuhet që në qendër në shkollë që ka qenë qendër votimi në Ferizaj është në renovim nuk e besoj që është marrë ndonjë vendim ka qenë I mëhershëm pra nuk e kanë kryer punën e tyre zyrtarët komunal zgjedhorë me vlersu gjendjen e qendrave të votimit ashtu siq e kanë për detyrë, apo qysh ka qenë e paraparë me planë operacionalë por ne mbi të gjitha si institucionë jemi në shërbim të votuesëve, në qofse vetëm këtu se tash këto janë fakte të kryme edhe duhet me I mbështet me kry shërbimin tjetër qe na mbetet me e inform keta votus me vazhdu më tutje e a vendosim sod a vendosim mbledhjen tjetër mu sëm prish pun por vetëm kjo është realiteti , këtë është mir me na e than sekretariati

Adnan Rrustemi: Unë, në emër të këshillit e sqarova padyshim qe ne i shërbejmë votuesve dhe ne do të angazhohemi cilen do situatë me ja mundësu votuesëve kudo qe ndodhen votimet dhe shprehjen e vullnetit të tyre me gjithatë duhet me theksu që si aktivitet i sekretariatit është tepër I vonshum edhe rjedhimisht mundet të karakterizohet pa përgjegjsi qe i rezulton nga neglizhenca, ne e kemi për detyr si komisjon zgjedhorë. Ne kemi zyrtarë komunal përmanentë të përherëshëm të cilët kanë për detyrë menagjimin e kapacitetëve të gjdo qendre të votimit që fillim të procesit. Ne I kemi publiku lokacionet e qendrave të votimit ne e kemi bërë informimin për votuesëve për qendra të cilat janë alokuar për të votu, por nëse qëndrojn arsytimet se këto lokacione janë të pa shfrytzueshëm po e them kushtimishtë, për cilat nuk ka infumacion të mjaftueshëm na e kemi marrë vetëm një tabelë të cilat as nuk ka shpjegim individual për secilin në cilen gjendje është cila është arsya qe mundë të përdoret që duhet të dalin të cilat janë rreziqët për votuesit nëse mbetet aty ku kanë qenë dhe cilat janë përparsit e votuesit të cilët alokohen përveq këtyre është edhe ajo qe u tha edhe nga të tjerët se cilat janë mundësit e KQZ-s në këtë rastë të sekretariatit për me e zhvillu një fushatë une po e quaj të lokalizumë për këto hapsira për këto aplikacione të informimit të votuesëve që ka ndodhë ndrrimi I qendrave na është dhënë me gojë, jo me shkrim që në disa raste bëhet fjalë për ndrrim thuajëse simbolikë kuptimi që ne objektet qe bëhen me njëna tjetrën kanë ndrru funksjonë, por ka edhe lokacione të tjera që bëhen dhe kanë ndryshu që bëhen ne distance më të larta mir pajtohem që ne ta gjejmë një zgjidhje edhe të vendosim si situatë e veqantë por sekretariati pasi nesër të na pregaditë një raport me shkrim me tabelë sa është e mundur edhe cila qka duhet te bëjme ne këta votus që te

informojm për ndrrim te lokacionit te qendres së votimit jo per ndrrim te qendres se votimit te tyre.

Valdete Daka: Po e shoh që ka një koncensus që për nesër ta lëm kete pikë te rendit te dites, edhe sekretariati vjen me nje rekomandim ma précis dhe me një analizë te saktë. Vazhdojm me pikën tjetër, unë kërkoj falje që e kamë kalu këtë rekomandimin e ZRPP-ës po mendemi dhe në fund nuk është urgjente. Vazhdojm me pikën tjetër ajo është shqyrtimi dhe miratimi I përbërjes

Adnan Rrustemi: Faleminderit. Këshilli operativ zgjedhorë në dy mbledhje radhazi ka shqyrëtu të gjitha nominimet, respektivishtë propozimet e komesioneve komunale zgjedhore për përbërjen e këshillave të vendvotimeve sic e dime ne që këshillat e vendëvotimeve janë një trupë e rëndësishme e një niveli të vendvotimit që te bëhet administrimin e procesit zgjedhor, kshilli I operacioneve zgjedhore është përpjekur që në këtë suate që ndodhemi, dhe në përputhje me ligjin dhe dispozitat e këtij te garantoj një gjithëpërshirje në këto trupa sikurse dhe të sigurohet qe integriteti I prcesit zgjedhor të mundësohet, ne jemi mundu me trajtu komun për komun dhe rastë për rastë dhe si të till kshilli I operacionit zgjedhore e rekomandon KQZ-ën që t'I miratoj natyrisht që në ndonjë rastë specific nese ka ide që mundë te plotësohen ose permirësohet mund ta diskutojm por KOZ-I unanimisht e rekomandon këshillin nëse eventualisht ndonjë gabim teknik nuk eshte përvjedhë në një numër të madh të komisjonit dhe nuk është që ne cdo komunë kushtimisht po them se formula është e zbatushme njëjt por rekomandimi I kohës

Betim Gjoshi: Është mirë zoti Rikallo të rrin në zyre. Nuk është kolegiale me lëshu mbledhjen. Kryetare, i'u përshëndes të gjithëve! Po me vjen që ai e lëshoi mbledhjen, sepse nuk ka apsolutisht asnjë arsye më të vogël ta lëshoj mbledhjen. Pse është pozicionuar si anëtarë I KQZ-së në një subjekt, dhe përfaqëson këtu interesat vetëm të një subjekti I cili është I regjistruar tash në KQZ. Dhe, mendon që të gjitha subjektet tjera që janë të regjistruar, poashtu te komunitetit serb nuk duhet të jenë pjesmarrësë në ato qendra. Sepse, z.Gjoshi nuk deshi t'a përmend, por ne e kemi analizuar listen e komunave të veriut, dhe të gjithë anëtarët që kanë shkuar në këshillat e vendvotimeve janë te një partie, ose janë të kontrabanduara në atë, nëpërmes subjekteve të cilat fare nuk janë të regjistruara në KQZ. Ka emer të një subjekti I cili nuk është fare. Nuk ka asnjë arsye të veprojë kështu. Ose janë duke menduar që, ose është 2013, kur ka ekzistuar një marrëveshje që e ka bërë dikush tjetër jo KQZ-ja, që t'i mbushin kutitë e t'i bien. Tash nuk ka me mundë me I pru. Tash pa politikë hiç. Por, ajo që doli, dhe nuk deshi të ballafaqohet këtu me të vërtetën. Sepse çdo komunë është shikue në specifika, duke pas parasyshë që asnjë komunitet e asnjë subjekt të mos lëndohet, por të jenë të gjithë të barabartë. Është arritur me një koncensus. Mund të thëmi si të dojmë, por është arritë një koncensus, prandaj nuk është në rregull edhe kolegu jonë t'a lëshoj mbledhjen. Është e vërtetë që me radhë të tëra në mbledhjet e KQZ-së përfaqëson, shkurt një subjekt paraprak që ka ekzistuar dhe që është ndarë tash në 2-3 subjekte,

dhe po e mbanë pozicionimin e atij subjekti të cilit faktikisht është I ndarë në 3 pjesë dhe ata 3 persona marrin pjesë në zgjedhje. Tash nuk mund ne të thëmi që ajo njësi e tij duhet t`I ketë të gjithë anëtarët në këshilla te vendvotimeve. Faleminderit!

Valdete Daka: Faleminderit, Sami! Po, urdhëro Adnan!

Adnan Rrustemi: së pari, në do të duhet t`a trajtonim komunë për komunë, edhe t`I shohim ku janë eventualisht vërejtjet konkrete. E dyta, ata që kanë pretenduar ose pretendojnë që në komuna të caktuara do t`a vendosin kontrollin mbi trupat e administrimit të zgjedhjeve në çdo vendvotim për qëllime, që në fakt nuk janë fare të lidhura në kuptimin e integritetit të zgjedhjeve le t`a harrojnë që mund t`a përdorin, ose mund t`I përbëjnë këshillat e vendvotimeve në tërësi me emra të të njejtit subjekt politik, duke I shpërndarë nëpër subjekte fantome, e në emer të KKZ-së e kështu me radhe. Kjo gjë nuk do të lejohet në asnjë mënyrë, por kjo nuk është arsye për t`a kontestuar komplet procesin. E treta, sekretariati duhet të n`a dërgoj emrat e secilit komisioner për secilin subjekt politik. Duhet të garantohet që ata janë shtetas të Republikës së Kosovës, janë votues të komunës në fjalë në përputhje me ligjin. Nuk janë të denuar për vepra çfare I përcakton ligji. Ne kemi pas konsideratë si këshill I operacioneve zgjedhore që, për shkak të afateve të shkurtra nuk kemi pas mundësi me I identifikuar emer për emer. Jemi përqendruar te formula dhe përbërja, por kjo nuk mundë të ndodh pa u dërguar dhe me një farë mënyrë pa u qertifiku te secili komisioner që të garantojm që njerëzit ose zyrtart qe do te angazhohen në ditën e zgjedhëjeve janë në përputhje me ligjin është e vërtetë që ka pas pretendime dhe ka ende që në komunat konkrete të mbizotërohet ose të kontrollohet komplet komisioni I këshillit të vendvotimeve, për qëllime për ta kontrolluar, orkestëruar, manipuluar, e kështu me radhë procesin në vendvotimin perkatëse për ndonjë komune tjejer, për ndonjë vendvotim ne mundë ta diskutojm komunë për komunë nëse është gabu në kshillin për operacione zgjedhore, për tjerat parimi ka qenë I qartë, është ndjekë parimi ligjor për ta siguruar gjithë përfshirjen përfaqësimin e palëve ne proces dhe për ta siguru integritetin e zgjedhëjeve.

Valdete Daka: Faleminderit! Sdi a kemi nevojë me vazhduar, sepse te gjithë po pajtohemi që na të vazhdojmë komunë për komunë, në ato komuna ku nuk ka mos pajtime I shohim cilat janë, dhe vazhdojm.

Betim Gjoshi: Unë nuk kam çka me I shtuar as me I hjekur parafolsëve të mi, Samiu dhe Adnanit. Na jemi mundu që se pari ballancën etnike me rujtë, këshillat e vendvotimëve janë krijuar duke u bazuarë ne vendvotim për vendvotim në bazën etnike, e dyta jemi munduar që me qenë shumë subjekte te përfshira dhe me qenë te perfaqësuar të gjithë ato që ligji u`a ka dhënë hapsirën dy herë në ditë prej atyre parlamentare deri te subjektet e reja, varësisht prej rëndësis që kanë për secilin vendvotim që mos t`i bie as një vendvotim të jetë në duar të një subjekti politik, por, as që ti humb e drejta dikujt, pra jemi munduar njëfar gjithëpërfshirje në nivel të vendit, muk do të thotë se ja kemi qëlluar për këtë I kemi sjellë në shqyrtim një për një secilin nga këto komuna e pastaj do të na dërgohen edhe emrat në bazë të këtyre formulave me garancionin e verifikimit siq na kanë sjellë të gjithë që I kanë plotësuar ato kritere pra, të gjithë

ata që janë votues të Kosovës që nuk kanë ndonjë precedent penal në përputhje me rregullatoren mos ti përmendi të gjitha rastet konkrete, mund edhe të jenë gabuar se sekretariat nuk na ka pru informacione 3-4 komuna krejt kemipasur ndërhyrje për shkak se kanë qenë të sakta kanë qenë përfshirë etni që nuk ka asnjë votuese të asaj etnie në atë komunë e para, e dyta ka pasur më shumë të koncentruar në duar të një subjekti dhe nuk i ka dhënë hapsirë të cilat janë edhe parlamentare dhe i përkasin atij komuniteti janë të qertifiluara për këto zgjedhje, pjesën tjetër mendoj që 33-34 komuna nuk ka pasur ndonjë problem të theksuar, ka mundur të jetë me plus minus një komisioner, por, në të cilat një konsensusi kemi ardhur deri këtu ata që kemi qenë 4 pjesëmarrës dmth që mos ti hym në hak dikujt. Kishim filluar një nga një kemi komunën e parë në bazë të rendit kujtoj Deqanin.

Valdete Daka: Unë këtu e kam Gjakovën të parën por nuk ka lidhje. Deqani ok. Deqani i keni para jush përbërjen e KVV-së. Aka dikush vërejtje për komunën e Deqanit. Aka nevojë me lexu, jo, e keni para jush secili. Kush është për, faleminderit. Cila është tjetra, Gjakova atëherë e dyta, a ka dikush vërejtje për komunën e Gjakovës. Nëse jo, kush është për, faleminderit. Glogovci, a ka dikush vërejtje, kush është për. Gjilani, për komunën e Gjilanit a ka dikush vërejtje, nëse jo kush është për, faleminderit. Komuna e Dragashit, e kemi të renë, e keni këtë me 16-15-15 a është ajo. Kush është për këtë listë, faleminderit. Istogu, a ka dikush vërejtje, kush është për, faleminderit.

Valdete Daka: Dmth pa këtë subjektin politik, e rregullojmë. Kaqaniku, a ka dikush vërejtje nëse jo kush është për, faleminderit. Miratohet...

Valdete Daka: Atëherë për se me bërë zgjedhje aty, aty e dinë rezultatin. Atëherë, e keni përmisuar këtë, a t' a dërgojmë për përmisim? Këto nuk janë të përmisuara. Fushë Kosova, Kush është për që të përmisohet? Faleminderit! Kamenica. Kush është për Kamenicë?

Betim Gjoshi: kryetare, unë apstenoj, sepse këtu u shtuan dy subjekte. 2 janë në vend të një. 4 vendvotime janë ndarë në 2 subjekte.

Adnan Rrustemi: mos janë 8 s' e nga 4 kryesues janë.

Valdete Daka: 4 kryesues dhe 13 anëtarë.

Adnan Rrustemi: kjo tabela nuk është asnjehere mjaftueshem shpjeguese. Tash nuk po e dimë këta 13 anëtarë të këtij subjekti të parë, në pikën 4. S'po përmendi emra. A janë ndarë vetëm për këto 8 vendvotime, apo është ideja me i nda edhe në ndonjë vendvotim tjetër ku mundet me qenë përbërja, sepse edhe subjektet e para kanë edhe anëtarë, ish dashtë me pas dhe jemi marrë vesh me pas. Kështu që 3 subjektet e para e kanë nga një anëtarë në këto vendvotime kënde nuk është masandej e dominuar komplet vetëm nga një subjekt politik. Por, kjo nuk po sqarohet.

Ilir Gashi: A kanë ardhë këto drejtëpërdrejtë nga sekretariati, apo kanë qenë në këshill?

Adnan Rrustemi: Kanë qenë në këshillë i kemi kthyer me këto përmirësime .

Valdete Daka: Novobër, shkojmë me Novobërd. Aëhtë në rregull Novobërda. Urdhëro Bajram.

Sami Hamiti: Zotria e përfaqëson vetem listën sërbska këtu janë edhe 3 parti të tjera që janë, ai po don këta mi fshi, atë problem e ka ai.

Valdete Daka: Novobërda, kush është për...? Miratohet...

Betim Gjoshi: Kryetare që të jemi të qartë, komuniteti për të cilin po flasim është i përfaqësuar skajshmërisht në secilin vendëvotim më shumë se që i takonë me ligj dmth në vendëvotimë ku janë ata shumicë kanë minimum 80 përqind të anëtareve të këshillave të vendëvotimit. Kemi problem se tendenca ka qenë që të gjitha këyo këshilla të vendëvotimit me ju dhënë një subjekti politik që të ketë lirin ai si për ta përcaktuar fituesin, edhe kandidatët brenda atij fituesi, ose me një fjalë mi dëmtu integritetin e këtij procesi zgjedhorë. Ne si Komision Qëndror Zgjedhorë e kemi për detyrë për ta ruajtur intregritetin e procesit zgjedhorë, nuk e kemi për detyrë agjendën e asnjë subjekti politik me realize, dmth qytetarët bile bile për ti respektuar gjithmonë ata qytetarë që e njohin Kosovën Republikë edhe shtet Sovran dhe që kanë kontribuar për këtë shtet deri sot, dhe me ju dhënë të drejtat dhe mundësitë afirmative se jo negative, edhe për këtë jemi munduar, por, ka tendecë të vazhdueshme edhe këtu nuk e ka kry rolin e sekretariatit dmth duhet të jemi të qartë dmth ka dështuar vazhdimisht, ne dje e kemi pasur të njejtat probleme I kemi kthy, sot I kemi kthy të njejtat probleme parp nuk janë marr masa, pra ata deri nesër duhet ta rregullojnë këtë problem.

Valdete Daka: Faleminderit.Atëherë vazhdojmë me Novobërd....! A u kry Mitrovica...?

Betim Gjoshi: Kryetare vetëm diqka, kur të vijm te këto komuna që that ju kemi me pasur problem, na i tregoni ju përpara Adnan, si kryesues i këshillit që ta dimë cilat kanë qenë ato dilemat e juaja, le ta qartësojmë, Nenadi në qofëse se e kanë marr obligime personale për diqka që nuk është në obligimin e anëtarit të Komisionit Qëndrorë të Zgjedhjeve, Kqz-ja nuk bëhet palë e partive politike, neve na vjen keq për sjelljen e tij, nuk ka ndodhur asnje herë që një anëtarë I Kqz-së me ik prej autorizimeve të tij që I ka me ligj dhe me Kushtetutë.

Valdete Daka: Mitrovica e Jugut...!

Adnan Rrustemi: Janë 4 komuna të cilat duhet të jenë të interesuar për sqarime por, nuk do të ju lodhi, do të mundohem me shpëtu edhe vetëvetën edhe juve, si mostër është Mitrovica e Jugut, prej sekretariatit një sqarim, komunitetin të cilin unë e përfaqësoj në Mitrovicën e Jugut në zgjedhje e kaluara me rezultat kryesisht të njejtë ka pasur dyfishin e këshilltarëve të anëtarve të këshillavë të vendëvotimit, kësaj here më pak se gjysmën e atij numri, një sqarim prej sekretariatitsi dhe do të jetë mostër për komunat e tjera duhet ti votoj për shkak të parimeve dhe procesit, por bile një përgjegje të logjikshme.

Eshref Vishi: Kryetare nese bënë, parimisht e kemi parë si konsensus që mi krahasu me 2014 nëse kanë pasur nominime edhe kanë nominime, edhe kamë pak se në 2014, le të shtohen 9

vendëvotime janë , 57 komisioner I kanë pasur nuk na prish punë asgjë nëse shtohen edhe 30 e ca nqoftëse janë më pak.

Valdete Daka: Ai qëndrim ka qenë që asnjë më pak se ajo që ka qenë në vitin 2014, ashtu jemi dakorduar.

Betim Gjoshi: Po parimi ka qenë që të most ë çënohet përfaqësimi I asnjë subjekti, asnjë komuniteti që në kushte të njëjta ka pasur përfaqësim të njëjtë, parimi ka qenë duhet ta themi këtu, natyrisht që unë nuk jam kundër, veq le të sigurohet sekretariati, a ka pasur nominime, edhe a ka nominime edhe për vendëvotime tjera, megjithëse një parim ka qenë që edhe të merret për bazë struktura etnike e lokacioneve të vendëvotimeve, dmth kjo ka qenë parimi. E njetja hjë ka vle edhe për Prizrenin. Me një vendvotim në një fshat, të Mitrovicës po e zë, ku struktura etnike është monortnike po e zë. Kjo ka qenë ideja që më shkuar me formulën 3,2,2. Parimi ka qenë ky. Në raste të tjera, kudo që ka përfaqësim, dhe ku ka vota, ideja me vendvotime me qendra të votimit. Unë nuk jam kundër, vetëm të sigurohemi që partia në fjalë I dërgon vërtetë komisioneret e vet. Kjo është shumë e rëndësishme për procesin, ama nuk jam kundër.

Ercan Spat: Siç thash paraprakisht, prap po du me nënvizuar. Për parime, për hirë të procesit, unë padiskutim do t'i votoj të gjitha. Por, nëse hyjmë në diskutime, atëherë diskutimet duhet edhe të zgjerohen. Mos të jenët të njeanshme. Komunitat monoetnike jane edhe të komuniteteve tjera, atëherë duhet të vlejë parimi për të gjithë. Ne në këshill, ku janë anëtarë edhe unë, u pajtuam për komunën e Prizrenit. Njëri prej anëtarëve. Nënvizojë. Të gjithë u dakorduam. Ashtuqë, me këto mmos të humbim kohë. Ishte propozimi I zotit Betim.

Valdete Daka: Le të plotësohet atëherë.

Adnan Rrustemi: Shumë mirë! Edhe në Gjilan le të përseritet e njëjta ngjë. Le të sigurohet që I dërgon partia dhe komuniteti nominimet e tij.

Valdete Daka: Kush është për, me këtë plotësim? Faleminderit!

Kjo pikë ë rendit të ditës, me plotësimet u miratua pa kundërshtime.

Valdete Daka: u Vazhdojmë me Lipjanin.... E pashë edhe unë. Gabim teknik është. Lipjani...? A ka dikush diçka?

Betim Gjoshi: Për mos me lanë njëjtë. Edhe këtu poër një qendër votimi ku janë shumicë komunitet nuk kanë të gjitha vendvotimet. Flietet për 3,4 komisioner

Valdete Daka: Atëherë le të rregullohet edhe aty. Mirë me këto vendvotime, me këtë ndryshim kush është për? Lipjani? Faleminderit!

Kjo pikë ë rendit të ditës, me plotësimet u miratua.

Valdete Daka: Obilqi? A ka dikush vërejtje? Jo. Kush është për? Miratohet

Rahoveci? A ka dikush vërejtje për Rahovecin? Kush është për ? Miratohet...

Betim Gjoshi: Lryetare, kjo është çështje teknike. Kanë harruar teknikisht me formulë, me i`a vendosë rezervat. 10 % duhet rezervat e partive. Me këtë ndryshim miratohet.

Valdete Daka: me këtë ndryshim të rezervave ? U bë. Kush është për? Miratohet. Podujeva? A ka ndonjë vërejtje , Kush është për...? Miratohet. Peja?

Betim Gjoshi: Kjo është me drejt në bazë të rezultatëve, edhe na e kemi pasë si vretje dhe si kshill, Peja a tu u kanë në qofse ka komunitet janë vendë votime të pastërta të ni komuniteti kryesues, Por edhe në atë aspekt pe shof që nuk e kemi përmisu...

Valdete Daka: A nuk është përmisu a?

Valdete Daka: Atë here kush është për këto ndryshime ? Miratohet... Prizreni, a ka ndryshime prizreni...? Miratohet.

Valdete Daka: Suhareka, a është në rregull, kush është për? Miratohet.

Shtërrpc, a është në rregull Shtërrpca , kush është për ? Miratohet.

Shtime, kush është për në qofse ska naj vëretje? Miratohet.

Ferizaj, nuk kemi vëretje , kush është për? Miratohet.

Vushtrri, a kemi vëretje, kush është për ? Miratohet.

Viti, kush është për? Miratohet.

Malishevë, kush është për ? Miratohet.

Junikë, kush është për ? Miratohet.

Graqanicë, a ka vëretje kush është për? Miratohet.

Hani i Elezit, kush është për ? Miratohet.

Mamusha, a ka vëretje nese jo, kush është për...? Miratohet.

Mitrovica e Veriut...?

Betim Gjoshi: Kryetare, unë mendoj me tërhjek këta për momentin...

Valdete Daka: Ne rregull pra Mitrovicen pe tërhjekim per momentin...

Kllokoti, kush është për ? Miratohet.

Partesh kush është për ? Miratohet.

Ranillukë , kush është për ? Miratohet.

Skenderaj. Kush është për ? Miratohet.

Zubin Potoku...?

Betim Gjoshi: Kryetare, nëse më lejohet që në krejt këto komuna është i një komunitetit që është pa as një votues e as një banor në komunë, dmth që me e pasë të qart dmth. Ku ka apliku për një subjekt, nuk e di unë sa herë duhet me jav thanë unë...! Me sa po e shoh këtu s`ka numër 5 hiq...!

Valdete Daka: Ska numër 5 hiq qitu të Zubin Potoku.

Betim Gjoshi: Një komunitet që nuk egzistonë.

Valdete Daka: Atë here këto 4 Komuna po I lajmë nesër at here vazhdojmë më pikën tjetër. Këshilli operacional zgjedhor , kushtimit po thomë mbase është sekretariati për me e prezantu në këshillin operacional zgjedhorë në raportin ndërkombëtar për procesin e krijimit të listës së votuesve respektivisht rekomandimi për komisionin për qertifikimin e listës se votuesëve , Lista përfundimtare e votuesëve është ka kapercyer nëpër procese të cilat I parashef,ligji me rregulla të kqz-së nga pranimi I ekstratëve , të agjencjonit të regjistrimeve civil në krijimin e listës së votuesëve nëse secilen vazë e parashef. Procesi në përfundimishtë lista e votuesëve I ka përafersisht 72.941 emra nëpër komuna me dallim prej 155.150 mijë votus më shum se ne rast të zgjedhjeve të viti të kalum të 2014 siq e dijmë numri I qendrave të votimit është 889 me 91 qendra të votimit të shtuara në krahasim të zgjedhjeve të 2014 Numri I vendë votimeve është 990 apo 116 vend votime ma shum se san ë zgjedhjet e 2014 , procesi se si është përshkru janë 118.448 votuesë të rinjë në këto zgjedhje që perfshihen për her të parë 360.435 votues që nuk kan qenë në listen përfundimtare të zgjedhjeve të 2014 që mund të konsiderohen , votues për herë të parë nuk bëhet fjalë për votus për herë të parë në kuptimin e 18 vjeqarëve , por thjeshtë për nga arsyjet ma të ndryshme jan rikthy apo janë përfshi në regjistrin civil numri I emrave I përonave që janë larguar që diskutohet në mesë të zgjedhjeve të hyra 2014-2017 është 330.542 numri I votusve që kan hequr dorë gjatë kësaj periudhe 31.733 dhe numri I votuesëve që kan ndërruar adresë që gjatë kësaj periudhe që 36.265-84.417 janë caktuar ne qendrat e reja të votuesëve të informuar nga logjistika me kartolina të paktën kështu ishtë ne planë të aktivitetëve tona the 6.976 votues jan caktuar ne qendra të votimit në bazë të mënyres se si kan votu ë gusht të zgjedhjeve të 2014 lista e votuesëve e procesëve ka kalu edhe në periudhen e shërbimit votues dmth të kerkesave të ndrrimit votues I kemi pas 1919 kërkesa që jane parashtru nëpër zyra te komisionit komunal 3305 ditë qe jan parashtru nëpër mjet aplikacionit, online 2870 janë aprovu si të tilla, 292 janë refuzu për shkakë që votusi ka kërku ndrrim të qendrave në qendrat që ne I konsiderojmë split, të ndara nga ama dhe nuk mund të konsiderohet si qendër e re. është aneks I pjesës paraprake. Dhe të tjerët që janë refuzuar për arsye të ndryshme. 282 emra janë pranuar nga këshilli gjyqsorë të cilëve i`u është hjekur zotësia e veprimit dhe sekretariati ka mbërrri 140 me I identifikuar nga këta. Dhe I ka larguar nga lista e votuesve. Në periudhën e kundërshimit nuk ka pasur asnjë kërkesë siç është raportuar. Si pjesë e këtij dokumenti është procesi I krijimit të listës së votuesve jashtë vendit. Raportohet se janë pranuar 20 354 aplikacione. Janë mregjistruar si votues të suksesshem 15 118. Janë refuzuar 5 236. 14 aplikues janë refuzuar sepse kanë qenë nën moshën 18 vjeçare. 118 për shkak që nuk kanë nënshkruar formularin. 5 104 janë refuzuar sepse nuk I kanë plotësuar kriteret e zotësisë juridike në bazë të rregullatives. Në fund, janë edhe disa rekomandime për agjensionin e regjistrimit civil dhe ndarja e votuesve për çdo komunë, numri I qendrave të votimit dhe numri I vendvotimeve, këshilli operacioneve zgjedhore rekomandon KQZ-në që t`a çertifikoj. Për pyetjet dhe sqarimet shtesë është sekretariati.

Betim Gjoshi: Së pari, I falenderoj të gjithë që kanëpunuar listën votuese. Vlenë me I përmend tri fakte shumë të rëndësishme që listen votuese e bëjnë më të mirë. E para, kemi 33 542 persona të vdekur që janë larguar nga lista në tri vitet e fundit. E dyta, kemi 6 196 votues që kanë votuar në zgjedhjet e fundit me kusht dhe I kemi vendos në ato vendvotime ku kanë votuar me kusht.

Kjo është një hap I mirë. E treta, janë 3 350 aplikime për ndërrim qendre të votimit në formen online, që është një risi që e kemi përdorë në këto zgjedhje, e që në zgjedhjet e ardhshme mundet me u përdorë edhe më mirë, kuptohet brenda komunës. Unë I kisha falenderuar për këtë. Ne këto hapa duhet me I forcu me rregullativë ligjore. Kjo është domosdoshmëri që për zgjedhjet locale me I forcuar me rregullativë ligjore. Çka desha të them, e fundit është që, ne, po e shfrytëzoj edhe prezencen e mediave, është mirë me kërkuar nga sot, përmes të gjithë mekanizmave tonë, përfshirë edhe zedhënësit, të gjithë votuesve të Kosovës, që me parë ku e kanë vendvotimin e vet, që mos me vrapuar ditën e zgjedhjeve me gjetë vetën ne lista. Lista nga sot është përfundimtare, dhe të gjithë në uebfaqen tonë mundemi me shikuar ku e kemi vendvotimin e sakt, në ditën e zgjedhjeve me 11 qershor. Mundemi me potencuar, sa te mundemi, secili prej nesh, përmes kampanjes së infomimit public, përmes zëdhënësit tonë, me qëllim që votuesit në ditën e zgjedhjeve me ditë sakt s`e ku kanë më votuar. Faleminderit!

Valdete Daka: Faleminderit, Betim! A ka diçka tjetër sa i përket listës së votuesve? nëse jo kush është që kjo listë të çertifkohet si e tillë? Faleminderit! I falenderojmë të listës votuese! Të gjithë ata që janë marrë me ditë të tëra me punë.

Komisioni certifikoj Listën e Votuesve.

Valdete Daka: Vazhdojmë me pikën tjetër të, shqyrtimi dhe miratimi i anëtarit të KKZ-së në Istog.

Adnan Rrustemi: Kemi pasur një shkresë. Po e shoh që është e bashkangjitur, për një kërkesë të një partie, në këtë rast nga komuna e Istogut, që referuar rezultatit dhe numrit të banorëve. Dhe fakti që në zgjedhjet e kaluara ka pasur përfaqësim ka parashtruar kërkesë. Ne kemi kërkuar nga sekretariati që me bë një analize dhe me pa a ka pasë përfaqësim në vitin 2014, dhe me n`a treguar numrin e votuesve për këtë parti. Bëhet fjalë për Partinë Liberale Egjiptjane. Por, nuk po e shoh që e kemi vlersimin e sekretariatit. A mundesh me n`a treguar siç kemi kërkuar si këshill I operacioneve zgjedhore që kjo parti politike ka pasur përfaqësim në vitin 2014 në KKZ në Istog? Siç ka kërkuar KOZ-i. Atëherë rekomandimi I KOZ-it ka qenë që të miratohet si I tillë në bazë të verifikimit që bëhet në procesin e 2014-es.

Betim Gjoshi: Nëse jemi të qartë, komuniteti a ka pasur përfaqësues? Në 2014 po...Le të shkruhet sakt si anëtarë plotesues, siç e thotë ligji.

Valdete Daka: Kush është për? Faleminderit!

Komisioni miratoi këtë pikë të rendit të ditës

Betim Gjoshi: kryetare, a bën një kërkesë të përgjithshme. Sekretariati është mirë, ne jemi të gatshëm me mbajtë mbledhje dhe në ora 00:00, vetëm le të të na mbanë të përgatitur. Ka 4,5 ditë që jemi duke mbajtur mbledhje pa përgatitur. Kryeshe, edhe në zgjedhjet e Drenasit të kam

thënë, është mirë me I pa materilet para se me ardhë te ne. nuk mundemi me mbajtë mbledhje përmendësh.

Valdete Daka: Vazhdojmë me aktivitetet të ZRPP-së. urdhëro, drejtoreshë!

1- Falemendeit, kryetare! Zyra duke u bazuar në nenin 54.1 të ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, dhe nenit 3 të rregullës zgjedhore numer 07 për vëzhguesit e zgjedhjeve, si dhe nenit 3.1 të rregullës zgjedhore numer 15 /2013. Gjithshtu duke u bazuar në planin operacional të KQZ-së ka përgatitur rekomandimin për akreditimin e vëzhguesve të 16 organizatave të vëzhguesve. Ju I keni 2 rekomandime, për arsye sepse njëri rekomandim është përgatit pak para mbledhjes. E kemi marrur listen me kërkesa për 50 vëzhgues shtesë. Janë plotësuar të gjitha kushtet, sepse janë procesuar aplikacionet, dhe zyra konsideron s`e të gjitha kushtet e parapara sipas nenit 54 dhe 55 te ligjit janë plotësuar dhe rekomandon KQZ-në t`I akreditoj 350 vëzhgues. Të listuara I gjëni...

Valdete Daka: Unë do t`i lexoj numrin dhe institucionin i cili ka apikuar për akreditim. Pra, i kemi 50 vëzhgues të BE-së. Kush është për?

Adnan Rrustemi: Po e shoh që ka emra te vendorëve shumë. Nuk e di a bëhet fjalë për punëtorë që janë angazhuar, apo?

Valdete Daka: Sigurisht janë të angazhuar nga organizatat. Vazhdojmë edhe me rekomandimin tjetër. I keni të bashkangjitura edhe institucionet me emra. Kush është për?

betim Gjoshi: Tema që kam sjellë në diskutim, me siguri që nuk jam i interesuar me i imponuar as unë as kolegët e mi, asnjëlloj teme Brenda KQZ-së, por e kam sjellë për debat. Ndoshta në ditet në vazhdim, nesër pasnesër me vendosë diçka. Ne të gjithë jemi të vetëdijshëm, kemi pasur rinumrim të kutive, në 2010, 2013 sa I përket votive të kandidatëve të subjekteve politike. Për shkak të lodhjes, ose me gabime të qëllimshme të gjitha këto kuti që kemi rinumruar kemi hasur që kemi pasur problem sa i përket votave të kandidatëve për deputet, për dallim që nuk kemi pasur problem me votat për parti. Gjatë kësaj ne kemi bërë edhe analiza. Jemi munduar secili prej anës tonë, por edhe prej sekretariatit, prej QNR-së dhe kemi ardhur në përfundim që nuk kemi një lëxim të mirë të votive për kandidat. Unë krejt çka sot po kërkoj është që ne me gjetë mënyrën dhe mekanizmin që me dërguar voten e votuesve në vendin e duhur. Unë kam disa ide, por unë e ngrita sot që nesër me diskutuar, e pasnesër me vendosë. Më shumë na duhen idetë profesionale të sekretariatit, ndoshta s`e tonat. Cilat janë mënyrat? Unë kam disa mënyra. E para është që ne duhet me rritë transparencën gjatë numrimit të votive për kandidat dhe duhet me rritë nivelin e trajnimit dhe me treguar që vota për kandidat është po aq e vlefshme sa për subjektin politik, sepse është vullnet I votuesit. E dyta, është mirë që të kombinohen çështja e lexuesve. Ne kemi këshilla me 7 anëtarë të vendvotimeve , dhe të ndahen në dy grupe, numrimi dhe leximi dhe verifikimi, që të vërtetohet secila votë e tyre të shkoj në vendin e duhur. E treta, që është edhe teknike, mund te jetë që ne të kemi disa lapskimika të veçantë për rata që I mbushin formularët, që çdo ndërhyrje të vërehët, nëse ata tentojnë me ndërhyrë në fletëvotim. E fundit, që

mendoj është që ne duhet t`I bëjmë të vetëdijshëm, që kodi penal dhe ligjet në fuqi, trajtimin për çfardo gabimi të qëllimshëm apo të paqëllimshëm , apo çfardo mashtrimi sa I përket votive të kandidatëve denon po aq sat ë subjekteve politike. Dhe, duhet të I njoftojme komisioneteët. Duhet të i njoftojmë edhe me numrin, që mbi 1000 personave deri sot i`u ka ngritë aktakuza për çështje të votive, dhe 90% kanë qenë për vota të kandidatëve jo për subjekte politike. Kjo është shumë me rëndesi që ne me pa si process dhe me garantuar më tutje që secilit qytetarë me I shkuar vota në vendin e duhur, jo vetëm sa i përket subjekteve politike, por edhe sa I përket kandidatëve. Kjo është ajo që deshta me biseduar sot, e me vendosur ditët e ardhshme. Ky nuk është shqetësim vetëm I imi. Është shqetësim i të gjithë atyre që janë në garë, sepse kanë filluar me u quajt si kandidat të komisionereve, etj. Pavarësishtë partisë apo etnie, s`e kemi pasur problem te të gjitha etnitë. Edhe, për mos me i qajte zemra askujt, ne është mirë që t`a ofrojmë një transoarencë të madhe. E di kemi marrë një hap të madh me skanimin e rezultateve, por është mirë që këtë t`a mbrojmë që edhe para se me u mbushë formularët të ketë një transparencë të madhe. Unë kaq pata. Ju mendoni. Këto idetë e mia munden mos me qenë të qëlluar. Dikush munden me pas ide shumë më të mira, por mendoni deri nesër ju , që nesër ose pasnesër, ose në ditët në vijmë të vijmë te një qendrim, ku mund t`a fusim në program të trajnimit dh eta rrisim transparencën dhe ruajtjen e votave të kandidatëve. Falemidnerit! Deri të një e ardhme kur t`a bëjmë votimin elektronik, ose të pakten numrimin elektronik që është I domosdoshëm.

Valdete Daka: Sa i përket kësaj, për kodin penal kishte me qenë mirë sepse janë 9 vepra penale të cilat i parasheh kodi penal. Kapitull i veçante është, dhe jane para ditës së zgjedhjeve, gjatë sitës së zgjedhjeve dhe pas ditës së zgjedhjeve ku mund të kryhen këto vepra penale. Dhe, kish me qenë mirë që me i njoftuar komisioneret me këto vepra penlae të cilat munden me i kry ditën e zgjedhjeve, s`e ata janë ditëne zgjedhjeve, me denimete parapara dhe si një lloj fushate të vetëdijësimit dhe me ia spjeguar, gjatë trajnimit sidomos, se çka janë pasojat e veprimeve të mundshme të tyre. Eventualisht nëse tentojnë me kry.

Valdete Daka: E diskutojmë këtë mbledhjen e ardhshme...

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare
